



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

**PALËVE:**

**AVOKATIT TË POPULLIT**, përfaqësuar nga **Znj. Erinda BALLANCA** (më poshtë “AP”)

dhe

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**, përfaqësuar nga **Z. Besnik DERVISHI** (më poshtë “KDIMP”)

si dhe

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**, përfaqësuar nga **Z. ROBERT GAJDA** (më poshtë “KMD”)

Të ndërgjegjshëm për rolin dhe detyrat e rëndësishme që Kushtetuta dhe ligjet organike kanë parashikuar për funksionimin e Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Në respekt të misionit dhe vlerave institucionale të përbashkëta të secilit nga këto institucione promovuese dhe mbrojtëse të të drejtave themelore të njeriut, Në respekt të detyrimeve që burojnë nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2015 për forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, Në mbështetje edhe të marrëveshjeve të mëparshme dypalëshe të nënshkruara mes institucioneve, përkatësisht: Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, (Mars 2018); Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (Maj 2018), si dhe mes dy Komisionerëve, (Korrik 2012), bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje si anekse, palët bien dakord për sa vijon:

## **Neni 1**

### **Objekti dhe qëllimi**

Objekti i kësaj Marrëveshje është institucionalizimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimi në rritje në fusha, ku ndërthuren kompetencat midis tre palëve, me qëllim:

1. Forcimin e një qasjeje të përbashkët, duke rritur ndikimin si institucione mbrojtëse dhe garantuese të të drejtave themelore të njeriut në jetën institucionale dhe shoqërore të Republikës së Shqipërisë;
2. Promovimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve nga veprimet dhe/ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që vepron për llogari të saj, si dhe të krijimit të një kulture të të drejtave njeriut;
3. Lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis institucioneve, në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe më veçanërisht në fushën e të drejtës për informim, mbrojtjes së të dhënave personale, e të drejtës për mosdiskriminim dhe barazi në ligj dhe para ligjit;
4. Zgjidhjen e çdo konflikti të konkrutit të kompetencave që mund të ekzistojnë ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Komisionerëve (KDIMDP dhe KMD), për shkak të përmbajtjes së ligjeve, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tyre, në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është Ligji Nr.8454, datë 4.2.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, Ligji Nr.119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*”, Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga Diskriminimi*”, dhe Ligji Nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

## **Neni 3**

### **Format dhe fushat e bashkëpunimit me prioritet**

Avokati i Popullit dhe Komisioneri Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, angazhohen të bashkëpunojnë me prioritet për:

1. Monitorimin e veprimtarisë ligjvënëse për garantimin nga ana e ligjvënësit e standardeve më të mira gjatë procesit të konsultimit të projekt-ligjeve para miratimit të tyre, si dhe

parashikimit në ligj të standarteve ndërkombëtare të të drejtave themelore të njeriut dhe mosdiskriminimit dhe bërjen e propozimeve përkatëse në kuadër të përmirësimeve ligjore.

2. Monitorimin e zbatimit të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, me një fokus të posaçëm tek Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës të përbashkëta dhe bërjen e raportimeve përkatëse mbi gjetjet.
3. Identifikimin e akteve ligjore dhe nënligjore që konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe paraqitjen bashkarisht si subjekte të legjitimuara të kërkesave për shfuqizim në Gjykatën Kushtetuese.
4. Monitorimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut kundër Shqipërisë, duke koordinuar mes aktorëve të ndryshëm për njëë kzekutim të shpejtë të vendimeve, dhe marrjen e masave përkatëse si detyrim ndërkombëtar.
5. Identifikimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga KDIMDP dhe KMD, si institucione ndërvepruese aktive pranë gjykatave për shkak të kompetencave vendimmarrëse administrative, dhe në bashkëveprim me Avokatin e Popullit, adresimin e gjetjeve dhe problematikave përkatëse pranë institucioneve përgjegjëse.
6. Ndjekjen bashkarisht ose përcjelljen e ankesave nga njëri institucion tek tjetri, në varësi të juridiksionit dhe kompetencës ligjore, me qëllim që personave të përfshirë në procedurë ankimit t'u garantohet një strategji mbrojtëse sa më efektive që të jetë e mundur për të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme.
7. Shfrytëzimin e zyrave rajonale vendore për shkëmbim dhe përcjellje ankesash dhe problematikash pranë institucioneve në qendër, si dhe bashkimin e kapaciteteve njerëzore pranë së njëjtës zyrë rajonale.
8. Koordinimi me Kuvendin në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve që i adresohen organeve të administratës publike, në përputhje dhe me kërkesat e vendimit nr. 49/2017 të Kuvendit "Mekanizmi i Përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj".

#### **Neni 4**

##### **Tipologji të tjera të bashkëpunimit**

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e trajnimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjen e stafëve përkatëse lidhur me temat dhe nevojat specifike profesionale.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare promovuese dhe ndërgjegjësuese.
3. Palët angazhohen të shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme njohuri dhe praktika të reja, në fushën e të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes.
4. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në ofrimin e ndihmës administrative sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për analiza ligjore, inspektime, raporte, rekomandime, studime apo kërkime me interes të përbashkët.
6. Palët angazhohen të bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, sugjerimeve, informacionit dhe praktikave administrative, që prekin objektin e veprimtarisë së palës tjetër dhe për të cilën ajo ka më tepër ekspertizë.

#### **Neni 5**

##### **Detyrimet**

1. Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, me qëllim që së bashku të rrisin efikasitetin institucional, dhe të forcojnë bashkëpunimin e integruar mes palëve për mbrojtjen e drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të çdo personi nga veprimet e paligjshme ose të parregullta të administratës publike.
2. Për realizimin e objektit të kësaj Marrëveshje, palët duhet të organizojnë, të paktën një herë në vit, takime të përbashkëta mes titullarëve apo mes përfaqësuesve të institucioneve për diskutime mbi ecurinë, vazhdimësinë dhe plotësimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

#### **Neni 6**

##### **Personi i kontaktit**

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me

zbatimin e kësaj Marrëveshje.

3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore ose me e-mail, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë menjëherë njëri-tjetrin, në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

### Neni 7 Mirëbesimi

1. Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje si dhe do të zbatojnë çdo detyrim që rrjedh nga legjislacioni që lidhet me dokumentacionin e administruar respektivisht.

### Neni 8 Dispozitat e fundit

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.
3. Marrëveshja përpilohet në 6 (gjashtë) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë AP-së, dy pranë KDIMDP dhe dy të tjera pranë KMD-së.

PËR  
KOMISIONERIN  
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Besnik DERVISHI

Tiranë, më: 23/11/2018

PËR KOMISIONERIN PËR  
MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI

Robert G. JDA

PËR  
AVOKATIN E POPULLIT  
Erinda BALLANCA  
TIRANË  
AVOKATI I POPULLIT

St. 23.11.2018

Faqe 5 of 5

K.D.I.M.DH.P.

Nr 1742 Prot.

Datë 23.11.2018

Prot: 1652  
dt: 23.11.2018